



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim (FM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondeve në Mirëbesim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në tri raste me vlerë totale prej 7,319€, nuk ishin dorëzuar garancionet financiare me rastin e lidhjes së kontratave komerciale siç kërkohet me rregullore.
- B1 Te të hyrat nga qiratë kishte vonesa në arkëtimin e tyre, të cilat varionin nga një muaj deri në një vit, madje kishte raste tjera që nuk ishin arkëtuar më gjatë se një vit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondeve në Mirëbesim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondeve në Mirëbesim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondeve në Mirëbesim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Mangësitë e identifikuara kryesisht kanë të bëjnë me fushën e llogarive të arkëtueshme, shitjeve me negociim direkt dhe të hyrave nga qiraja. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime, prej tyre një rekomandim i ri dhe tri të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos dorëzimi i garancionit financiar nga qiramarrësit

Gjetja Neni 9, paragrafi 4.1 i Rregullores Nr.03/2025 për Qiradhënien e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore përcakton që: Obligimi për dorëzim të garancionit financiar vlen për të gjithë qiramarrësit, aktualë dhe të ardhshëm, dhe aplikohet në përputhje me tipin dhe vlerën e qirasë si vijon: Për qiratë komerciale, kur vlera mujore e qirasë është 300 (treqind) euro ose më shumë, kërkohet dorëzimi i një garancioni financiar në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këto rregullore.

Në tri raste me vlerë totale prej 7,319€, nuk ishin dorëzuar garancionet financiare me rastin e lidhjes së kontratave komerciale siç kërkohet me rregullore. Prej tyre dy kontrata ishin vazhdim i kontratave ekzistuese, ndërsa njëra ishte kontratë e lidhur në vitin 2025.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të plotë të kërkesave rregullative gjatë procesit të lidhjes dhe vazhimit të kontratave të qirasë.

Ndikimi Mosrespektimi i kërkesave të rregullores për garancionin financiar ka rezultuar në mospërputhje me dispozitat rregullative dhe rrit rrezikun për vonesa në arkëtimin e të hyrave.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kërkesave të rregullores për qiradhënie, duke garantuar dorëzimin e obligueshëm të garancionit financiar për të gjitha rastet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mos arkëtimi i të hyrave nga qiratë

Gjetja Bazuar në kontratat e lidhura për qiranë ndërmjet qiradhënësit AKP/AL dhe OE për shfrytëzimin e pronave (objekte, toka) të NSH-ve në likuidim, qiramarrësi është i obliguar dhe pajtohet të paguaj shumat me pagesa brenda 5 ditëve të punës nga pranimi i një fature. AKP mund të pajtohet me kërkesën me shkrim nga qiradhënësi për të shfrytëzuar afatet e ndonjë pagese sipas kontratës së qirasë në situatën e jashtëzakonshme dhe pajtueshmëri të tilla do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse për këtë pajtohet qiradhënësi.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme lidhur me të hyrat nga qiratë, kemi testuar 61 mostra. Prej tyre 57 nuk kishin kryer obligimet ndaj AKP-së, pra ishin në vonesë. Vonesat kryesisht varionin nga një muaj deri në një vit, përfshirë edhe borxhe më të vjetra se një vit.

Nga mostrat e testuara, në 46 raste qiramarrësit ishin subject i procedurave përmbarimore ose gjyqësore për arkëtimin e borxheve, përfshirë edhe borxhe të pa arkëtuara nga vitet paraprake. Pavarësisht kësaj, gjatë vitit 2025 vetëm një kontratë ishte ndërprerë në kuadër të Administrimit Direkt,

për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësi.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme dhe mos marrjes së masave për ndërprerjen e kontratave në rastet e mos pagesës.

Ndikimi

Kjo gjendje rezulton me më pak fonde nga të hyrat dhe ulë mundësinë që të realizohen obligimet ndaj kreditorëve apo mbulimin e shpenzimeve për NSH-të që janë në proces të likuidimit.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollet tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore, në të kundërtën të marrin masa për ndërprerjen e kontratave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat nga shitja e aseteve

Gjatë vitit 2025, janë realizuar të hyra nga shitja e aseteve në vlerë prej 19,760,716€. Këto të hyra janë nga pagesat e pranuar lidhur me shitjen e aseteve të tenderuar përmes valëve të privatizimit, pranimet nga shpronësimet, shitja e aseteve përmes metodës të negocimit direkt si dhe të hyrat nga bartja e të drejtës banesore.

Çështja B2 - Mangësi në shqyrtimin e kërkesave të shitjeve me negocim direkt

Gjetja Sipas nenit 12 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 04/2024 për Shitjen Direkte është përcaktuar se: “Nga dita e regjistrimit të kërkesës, Agjencia ka për detyrë që brenda një afati optimal kohorë ta fillojë procedurën e shqyrtimit e cila do të përcaktohet në varësi të veprimeve, numrit të palëve dhe aspekteve dhe rrethanave tjera në Divizion”, duke e larguar afatin deri në 3 (tre) muaj për shqyrtimin e tyre siç ishte në nenin 8 të rregullores paraprake Nr. 16/2023 për shitjen direkte të aseteve. Po ashtu, neni 6, I rregullores paraprake të pika 2 përcaktonte se, shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte bazohet në rendin kronologjik sipas datës së ushtrimit të kërkesës, përjashtimisht do të merren në shqyrtim kërkesat të cilat janë të kompletuara (për të evituar vonesat e panevojshme dhe grumbullimin e lëndëve).

Tutje, pas shqyrtimit preliminar nga njësia për shitje direkte, në rastet kur aset i lëndor që është objekt i kërkesës ka elemente të asetit me karakter specifik, kërkesa së bashku me provat përcjellëse kalon tek Autoriteti i Likuidimit dhe se brenda 15 ditëve kalendarike obligohet ti përgjigjet me shkrim/postë elektronike duke dhënë pëlqimin apo mos pëlqimin se aset i ka bazë për iniciimin e procedurës së shitjes direkte.

Gjatë testimit të procedurës së shitjes me negocim direkt, kemi vërejtur se shqyrtimi i kërkesave nuk është bërë në mënyrë kronologjike, duke anashkaluar kërkesat më të vjetra që presin për shqyrtim që nga vitit 2011.

Bazuar në të dhënat për shitjet me negocim direkt, vërejmë se numri i kërkesave për blerje të aseteve (tokë, objekt) të bëra nga palët mbetet shumë i lartë. Sipas shënimeve të ofruara nga zyrtarët përgjegjës të AKP-së dhe nga regjistri i përgjithshëm i parashtrueseve të kërkesës, deri në dhjetor 2025 ishin 3,250, prej tyre 783 kërkesa ishin të pa shqyrtura nga Njësia për negocim direkt. Kjo tregon për një pritje të stërzgjatur, të kërkesave që presin për shqyrtim.

Sipas zyrtarëve, me rregulloren e brendshme të AKP-së për shitje direkte, mos shqyrtimi i kërkesave sipas rendit kronologjik lejohet për rastet e kërkesave që ishin të kompletuara ndaj atyre të pakompletuara. Megjithatë gjatë testeve tona ne nuk kemi vërejtur arsye se pse i janë dhënë prioritet disa kërkesave ndaj të tjerave.

Ndikimi Mosrespektimi i rendit kronologjik pa arsyetim të dokumentuar, dhe mungesa e transparencës në përzgjedhjen e kërkesave për shqyrtim si dhe ndryshimi i afatit kohor nga 3 muaj në afat optimal mund të ndikojë ka ndikuar në trajtim të pabarabartë të palëve si dhe që shumë lëndë të mos

trajtohen për vite të tëra. Kjo mund të ndikojë në uljen e besueshmërisë së procesit të shitjes direkte.

Rekomandimi B2

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte të bëhet në përputhje me brenda një afati të caktuar kohor afatet e përcaktuara me rregullore dhe se përzgjedhja e tyre për shqyrtim, jashtë rendit kronologjik duhet të bëhet vetëm në raste të dokumentuara qartë, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjitha palët aplikuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Të arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në PFV për vitin 2025 ishte 59,864,163€. Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë me vlerën financiare të pa arkëtuar nga valët e privatizimit/likuidimit, shitjeve përmes negocimit direkt dhe qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSH-ve.

Çështja B3 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme nga qiratë

Gjetja Neni 9 i Rregullores për Kornizën Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim, e miratuar nga Bordi i Drejtorëve më datë 23.02.2021 parasheh që në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqiten të ardhurat e arkëtueshme.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme nga qiratë, kemi identifikuar pesë raste ku AKP/FM kishte paraqitur në pasqyrat financiare llogari të arkëtueshme në vlerë prej 120,551€. Bazuar në dëshmitë mbështetëse të siguruara gjatë auditimit, vlera e këtyre llogarive rezultoi të jetë 31,786€. Si rezultat, llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar për 88,765€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme lidhur me harmonizimin dhe mbajtjen e saktë të regjistrit të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Gabimet e evidentuara në paraqitjen e llogarive të arkëtueshme kanë ndikuar në paraqitjen jo të saktë të informatave në PFV. Kjo mund të ndikojë negativisht në vlerësimin e performancës financiare të agjencisë.

Rekomandimi B3 Bordi i Drejtorëve duhet të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e llogarive të arkëtueshme, për të siguruar se ato regjistrohen dhe raportohen saktë në përputhje me dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për pranimet dhe pagesat e Fondeve në Mirëbesim

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme;


Tabela 1. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitet 2024 dhe 2025 në Euro (€)

Përshkrimi	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2024	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2024	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2025	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2025
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Gjithsej PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	23,957,418	46,199,490	26,401,891	72,601,381
Të hyrat nga shitja e aseteve	17,370,921	28,931,790	19,760,716	48,692,506
Të hyrat nga qiraja	5,519,944	15,673,104	6,101,809	21,774,913
Interesi i fituar	517,127	829,575	555,712	1,385,286
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	159,500	307,201	99,002	406,203
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	208,500	330,000	-330,000	0
Të hyra tjera	181,427	127,821	214,652	342,473
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	0	0	0	0
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË				
Gjithsej PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË	11,187,885	51,793,330	11,441,263	63,234,593
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	3,445,372	13,348,877	5,822,538	19,171,415
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	499,800	1,429,500	541,650	1,971,150
Mallra dhe shërbime	1,792,552	5,254,095	1,568,755	6,822,850
Shpenzimet komunale	105,587	491,097	144,712	635,810
Tatimet	750,623	2,334,367	961,218	3,295,585
Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)	89,028	5,502,886	21,329	5,524,215
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	0	0	0	0
Të tjera	7,098	32,969	3,234	36,202
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	4,746,620	23,648,333	3,576,357	27,224,690
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	-248,794	-248,794	-1,198,530	-1,447,325
Gjendja bankare	12,769,533	-5,593,839	14,960,628	9,366,789


Gjatë vitit 2025 pranimet apo të hyrat ishin 26,401,891€, që paraqet një rritje prej 10.2% krahasuar me vitin e kaluar. Këto të hyra kanë të bëjnë me shitjet, qiratë e aseteve të NSh-ve dhe të hyrave tjera.

Ndërsa, pagesat apo shpërndarjet gjatë vitit 2025 ishin në vlerë prej 11,441,263€, krahasuar me 11,187,885€ në vitin 2024. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i shpërndarjeve më të larta të pagesave për 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK.

Grafiku 1. Pranimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2024-2025



Grafiku 2. Pagesat sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2024-2025



4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Fondeve në Mirëbesim ka rezultuar me katër (4) rekomandime. FM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, një rekomandim ishte zbatuar, ndërsa tri rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollet tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore, në të kundërtën të marrin masa për ndërprerjen e kontratave përkatëse.	Nuk janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Të hyrat nga shitja e aseteve	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte të bëhet në përputhje me brenda një afati të caktuar kohor afatet e përcaktuara me rregullore dhe se përzgjedhja e tyre për shqyrtim, jashtë rendit kronologjik duhet të bëhet vetëm në raste të dokumentuara qartë, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjitha palët aplikuese.	Nuk janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi i Drejtorëve duhet të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e llogarive të arkëtueshme, për të siguruar se ato regjistrohen dhe raportohen saktë në përputhje me dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Nuk janë ndërmarra veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Detyrimet Kontingjente	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se regjistri i detyrimeve kontingjente të azhurnohet në kohë, në mënyrë që çdo informacioni i ri të reflektohet saktë dhe në kohë në pasqyrat financiare.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit




Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mos dorëzimi i garancionit financiar nga qiramarrësit	Sa i përket qiradhënies në rajonin e Mitrovicës me qiramarrësin “Simp” kontrata bazë e qirasë është nënshkruar me datë 01/04/2021 ndërsa aneks kontrata e qirasë përfshinë periudhën 01 shkurt 2025 - 31 janar 2026, ndërsa është vazhduar me datë 01 prill d.m.th para Rregullores së re të qiradhënies e cila parasheh sigurimin e garancisë financiare. Përndryshe, qiramarrësi është pagues i rregullt dhe asnjëherë nuk është paraqitur nevoja për vërejtje apo inicim të procedurës së përmbartimit. Sa i përket rastit të dytë NSH “Izolimi”, bëhet fjalë për një periudhë kohore kur qiramarrësi nuk ishte lajmëruar fare për arsye ligjore. Kontrata e qirasë është ndërprerë, procedura e përmbartimit është iniciuar ndërsa asetit është tenderuar për qiradhënie (tenderi mbahet me datë 26/06/2026). Lidhur me rastin e 3-të, NSH Tregu me qiramarrës, çështja qëndron në faktin se asnjë qiramarrës i Tregut nuk pranon të sjellë garanci financiare meqë kanë kosto ndërsa qiratë të vogla (një numër i vogël kanë qira 300€ <). Megjithatë qiramarrësi në marrëveshje me AL-në dhe në mungesë të garancisë ka parapaguar qiranë në vlerën e garancisë (shih bashkëlidhur faturën e fundit).	E gjetura qëndron. Sqarimet e ofruara nga AKP lidhur me natyrën e kontratave nuk e ndryshojnë faktin se në tri raste të identikuara nuk ishin dorëzuar garancionet financiare, ndonëse kjo kërkohet shprehimisht me Nenin 9, paragrafin 4.1 të Rregullores Nr. 03/2025. Kjo dispozitë e përcakton obligimin për dorëzimin e garancionit financiar për të gjithë qiramarrësit, aktualë dhe të ardhshëm, për kontratat komerciale me qira mujore prej 300€ ose më shumë. Për rrjedhojë, moszbatimi i kësaj kërkesë përbën mospërputhje me rregulloren në fuqi. Prandaj, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

Mos arkëtimi i të hyrave nga qiratë	Të gjitha rastet janë ndjekur qoftë përmes përmbarimit, qoftë përmes vërejtjeve siç ceket edhe në raportin e ZKA-së. Për ato që nuk janë iniciuar përmbarimet, qiramarrësit përkatës kanë bërë pagesat. Për të siguruar një menaxhim më të mirë të vonesave, AKP në muajin maj 2025 ka azhurnuar Rregulloren e qiradhënies tani me nr. 03/2025 e cila ka paraparë që të gjithë qiramarrësit me vlerën e qirasë mujore $\geq 300\text{€}$.	E gjetura qëndron. Pavarësisht veprimeve të ndërmarra nga AKP, një numër i konsiderueshëm i qiramarrësve nuk i kanë përmbushur detyrimet kontraktuale brenda afateve të përcaktuara. Ndryshimet në Rregulloren Nr. 03/2025 nuk ndikojnë në konstatimet e auditimit për periudhën e audituar. Prandaj, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Mangësi në shqyrtimin e kërkesave të shitjeve me negocim direkt	3 Çështja B2 - Mangësi në shqyrtimin e kërkesave të shitjeve me negocim direkt Në anën tjetër, DSHD pajtohet me të gjeturën se është tejkaluar rendi kronologjik në disa raste sikurse është: 1. Rasti të kërkesat të cilat NUK i plotësojnë kriteret e rregullores për shitje direkte dhe të njëjtat janë refuzuar me vendim të Bordit të Drejtoreve të AKP-së e që këtu kemi të bëjmë me 229 raste (kryesisht rastet e tejkalimit të rendit të vitit 2023, 2024 dhe 2025 mirëpo jo gjitha) e bazë për këtë ka qenë pika e veprimit dhe kërkesa e Bordi të Drejtoreve e dalë në punëtorinë e mbajtur në nëntor 2024, Bordi kishte përcaktuar si pikë veprimi që DShD-ja të rishikojë listën e kërkesave, të identifikojë rastet e qarta për refuzim dhe t'i procedojë ato në Bord pa vonesë. Po ashtu DSHD, ka praktikuar edhe që këto informata ti shpalos në memo të Bordit kur të njëjtat janë prezantuar në Bord për shqyrtim dhe vendimarrje. (Tabela 2 dhe dokumenti i pikave të veprimit të dalë nga punëtoria e Bordit) 2. Rastet tjera, kur është tejkaluar rendi kronologjik janë rastet e kërkesave me karakter komercial, e që për të njëjtat Bordi i Drejtoreve ka kërkuar që të njëjtat të shqyrtohen pa prituri rendin kronologjik. Edhe për këtë DSHD këto informata i ka shpalosur në memo të Bordit kur të njëjtat janë prezantuar në Bord për shqyrtim dhe vendimarrje. (shih memot e prezantuara në Bord). Për	E gjetura qëndron. Ne kemi marrë parasysh sqarimet e ofruara nga AKP lidhur me trajtimin prioritar të disa kategorive të kërkesave dhe rrethanat që kanë ndikuar në shqyrtimin e tyre. Megjithatë, këto sqarime nuk e ndryshojnë konstatimin se shqyrtimi i kërkesave nuk është zhvilluar në mënyrë konsistente sipas rendit kronologjik. Të dhënat e auditimit tregojnë se deri në fund të vitit 2025 kanë mbetur 783 kërkesa të pashqyrtuara, përfshirë kërkesa të parashtruara që nga viti 2011, gjë që tregon për vonesa të konsiderueshme në trajtimin e tyre. Për rrjedhojë, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

rastet e tejkalimit DSHD përshkruan arsyetimet sikurse ne Raportin përmbledhës për Bordin apo edhe ne Raportin Rekomandues.

3. Po ashtu deri më tani DSHD shqyrtuar edhe 316 lëndë për të cilët ka konstatuar se nuk kanë dokumentacion të kompletuar për të vazhduar procedimi i të njëjtave për vendimmarrje në Bord e që të njëjtëve ju është dërguar shkresë për kompletim të lëndës në mënyrë që e njëjta të mund të shqyrtohet për vendimmarrje. Edhe në këto raste për të mos ngecur në shqyrtimin e kërkesave dhe për ta përmbushur planin e punës është tejkualuar radha deri në marrjen e përgjigjes nga ana e tyre për kompletimin e së njëjtës (Shih Tabelën 3).

4. Rast tjetër për të cilat është tejkualuar rendi është lidhur me kërkesat e rastit të lagjes “Ramiz Sadiku” ne Prishtinë kryesisht të vitet 2018-2020 dhe të cilin rast DSHD e ka përgatitur duke e dorëzuar më parë të Manxhmenti për trajtim, mirëpo e njëjta nuk është proceduar tutje për faktin e diskutimit të mundësisë së shpronësimit të asaj ngastre nga institucionet publike.

5. Po ashtu është edhe rasti tjetër të cilin e kemi shqyrtuar rreth 30 kërkesa e që lidhet me lagjen në Komunën e Obiliqit po që e njëjta ka probleme kadastrale konkretisht mospërputhje mes gjendjes tekstuale dhe grafike.

Për më tepër ,sa i përket aspektit të trajtimit të lëndëve, Divizioni i Auditimit të Brendshëm në auditimin e bërë në DSHD për vitin 2024 ka dhënë rekomandim për formimin e dy grupeve të trajtimit të kërkesave e që njëri grup të trajtoj kërkesat e parashtruara në 3 vitet e fundit. Shih rekomandimin me poshtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

II
3816

No. 21
No. 21
No. 21
No. 21

Prishtinë / Pristina

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**
Auditore e Përgjithshme
Zyra Kombëtare e Auditimit

E nderuar Znj. Spanca,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE/PRAKLAJDEME
DISTRIBUIM: 10.08.2026
DISTRIBUIM: 10.08.2026

Nr. Pro.	Shif. Klasif.	Nr. Prot.	Nr. Fajc.
05	47	1170	1
Q. Un.	Klasif. Kod	Prot. No.	Dr. Stran.

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2025. (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin të çështja A1, që kemi komente dhe kundërshtim.
- Pajtohem pjesërisht me gjetjen dhe rekomandimin e çështjes B1, që kemi komente.
- Pajtohem pjesërisht me gjetjen dhe rekomandimin e çështjes B2, që kemi komente si dhe
- Pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin e çështjes B3 dhe kemi vetëm një sqarim.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit Final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Burim Leci
U.D. Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 26 qershor 2026

Në shtojcë:

Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.